



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Kodi i lëndës: INF 471
Lënda: Pediatri e avancuar

PROGRAMI I LËNDËS								
Pediatri e avancuar								
Titullari i lëndës:	Aurela Saliq Prof.asoc. PhD në Pediatri _____							
Ngarkesa:	ECTS	Orë mësimi në auditor					Studim individual	Totali
		Leksion	Seminar	Lab	Praktikë	Projekt klinik		
	12	60	15	0	75	0	150	300
Tipologjia e lëndës	Lëndë karakterizuese e programit							
Vitiakademik /Semestri kur zhvillohet lënda	Viti I, Semestri I							
Lloji i lëndës	E detyruar							
Programi i studimit	Master Profesional në Infermieri Pediatrike							
Kodi i lëndës	INF 471							
Adresa elektronike e titullarit / pedagogut të lëndës	aurela.dai@univlora.edu.al							

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	
Përshkrimi i lëndës	Në këtë lëndë studentët do të marrin njohuri të thelluara profesionale në fushën e zhvillimit human dhe patologjive pediatrike. Neonatologjia studion kujdesin shëndetsor për fëmijën e porsalindur dhe trajtimin e problemeve që mund të shfaqen gjatë periudhës neonatale. Rritja dhe zhvillimi human trajton konceptet dhe problematikat bazë që hasen gjatë zhvillimit të qënies njerëzore. Gjithashtu studentët do të mësohen të njohin dhe të trajtojnë sëmundjet më të shpeshta të moshës fëmijënore.
Objektivat e lëndës	<ul style="list-style-type: none">Njohja me faktorët riskantë të shëndetit të fëmijës gjatë periudhës perinatale.Vlerësimi dhe monitorimi i zhvillimit të fëmijës sipas standarteve bashkëkohore.Njohja me patologjitë e zhvillimit, neonatit dhe fëmijës sipas trakteve dhe sistemeve, si dhe me strategjitë e menaxhimit të tyre.
Rezultatet e pritshme	Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none">Të menaxhojnë pritjen dhe vlerësimin e fëmijës së porsalindur.Të adresojnë drejt patologjitë kryesore të periudhës perinatale.Të monitorojnë zhvillimin e fëmijës dhe të adresojnë problemet e zhvillimit.Të udhëheqin ushqyerjen natyrale dhe ablaktacionin e fëmijës.Të diagnostikojnë klinikisht patologjitë kryesore pediatrike.Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të fëmijëve me patologji pediatrike.Të prezantojnë raste klinike tërësore: nga etiologjia tek plani i asistencës

KONCEPTET THEMELORE

- 1 Periudha perinatale nënkupton 'kohën për-rreth lindjes së bebit'.
- 2 Qëllimi i kujdesit pediatrik është të reduktojë sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë fetale e neonatale / pediatrike.
- 3 Termi "zhvillimi i fëmijës" i referohet ndryshimeve biologjike, psikologjike, emocionale tek qëniet njerëzore nga lindja në fund të adoleshencës, gjatë së cilës individi progredon nga varësia në autonomi progresive.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

4 Diagnostikimi klinik dhe menaxhimi i integruar i patologjive neonatale dhe pediatrike adresohet sipas protokolleve të standartizuara.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	<p>Kapitulli I: Perinatologjia</p> <p>Tema 1 – Kujdesi perinatal. Periudha intrauterine. Metodrat e vlerësimit të fetusit <i>Qëllimi i kujdesit perinatal është të reduktojë sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë fetale e neonatale. Periudha intrauterine është periudha nga momenti i konceptimit të zigotës e derisa fetusit del nga barku i nënës.</i></p> <p>Tema 2 - Mjekësia fetale. Diagnoza prenatale dhe këshillimi gjenetik. <i>Njohja me faktorët e lidhur me nënën që ndikojnë mbi embrionin, fetusin apo të porsalindurin dhe pasojat mbi produktin e konceptimit.</i></p> <p>Tema 3 - Vuajtja fetale akute dhe kronike. Neonati në jetën pas lindjes. <i>Ndodhitë që ndërhyjnë në momentin e lindjes për të lejuar një kalim harmonik nga jeta ujore (brenda mitrës/ e varur nga nëna), në atë autonome (jashtë mitrës / ajrore).</i></p> <p>Tema 4 - Lindja normale (aspekti i pritjes së të porsalindurit). Ekzaminimi klinik i neonatit në term (anamneza). <i>Objektivat e pritjes së neonatit normal (AGA, term, pa patologji). Marrja e anamnezës së tij.</i></p> <p>Seminar 1 - Diagnoza prenatale dhe këshillimi gjenetik.</p> <p>Praktikë mësimore në pavionin e Neonatologji-OBS</p>	<p>⁽¹⁾fq.3-12</p> <p>⁽¹⁾fq.12-17 ⁽¹⁾fq.399-401</p> <p>⁽¹⁾fq.18-21</p> <p>⁽¹⁾fq.22-27</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</p>
II.	<p>Tema 5 - Ekzaminimi klinik i neonatit në term (ekzaminimi fizik) <i>Në periudhën neonatale ekzaminimi klinik, si në çdo moshë tjetër, duhet të jetë i plotë e i hollësishëm. Ai përfshin vlerësimin e gjendjes fizike dhe neuro-motore të të porsalindurit.</i></p> <p>Tema 6 - Ekzaminimi klinik i neonatit në term (ekzaminimi neuromotor) <i>Në periudhën neonatale ekzaminimi klinik, si në çdo moshë tjetër, duhet të jetë i plotë e i hollësishëm. Ai përfshin vlerësimin e gjendjes fizike dhe neuro-motore të të porsalindurit.</i></p> <p>Tema 7 - Vlerësimi i neonatit bazuar mbi kurbat e rritjes. Fëmija IUGR. Fëmija LGA, Preterm dhe Postterm. <i>Mënyra e vlerësimit të zhvillimit fizik të neonatit. Diagnostikimi dhe problemet e pritshme të të porsalindurve IUGR. Diagnostikimi dhe problemet e pritshme të të porsalindurve LGA, Preterm dhe Postterm.</i></p> <p>Tema 8 - Përcaktimi i moshës gestacionale. Neonati i shëndoshë-në rrezik-i sëmurë. <i>Përcaktimi i moshës pediatrike të barrës: bëhet në bazë të kriterëve fiziologjike dhe neurologjike të maturimit dhe na tregon pjekurinë reale të fëmijës. Vlerësimi nëse neonati është në gjendje të mirë, është në rrezik për të bërë ndonjë patologji apo është i sëmurë.</i></p> <p>Seminar 2 - Vlerësimi i zhvillimit fizik të neonatit.</p> <p>Praktikë mësimore në pavionin e Neonatologji-OBS</p>	<p>⁽¹⁾fq.30-35</p> <p>⁽¹⁾fq.36-38</p> <p>⁽¹⁾fq.39-52</p> <p>⁽¹⁾fq.53-56</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</p>
III.	<p>Tema 9 - Reanimacioni neonatal. Detresi respirator neonatal. Encefalopatia</p>		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p>hipoksiko-ishemike. <i>Rrjedhojat e asfiksisë tek i porsalinduri dhe plani i trajtimit të saj. Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Detresit respirator të të porsalindurit. Klasifikimi Sarnat.</i></p> <p>Tema 10 - Ikteri neonatal. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Hiperbilirubinemisë së të porsalindurit.</i></p> <p>Tema 11 - Hipotermia tek neonati. Hipertermia tek neonati. Hipoglicemia neonatale. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Hipotermisë së të porsalindurit.</i> <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Hipoglicemisë së të porsalindurit.</i></p> <p>Tema 12 - Infeksionet neonatale. Dehidrimi akut. Cianoza tek neonati. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Infeksioneve të të porsalindurit.</i> <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Dehidrimit dhe Cianozës.</i></p> <p>Seminar 3 - Reanimacioni neonatal. Praktikë mësimore në pavionin e Neonatologji-OBS</p>	<p>⁽¹⁾fq.57-70</p> <p>⁽¹⁾fq.71-77</p> <p>⁽¹⁾fq.78-87</p> <p>⁽¹⁾fq.88-93</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</p>
IV.	<p>Tema 13 - Konvulsionet neonatale. Enterokoliti ulçero-nekrotik <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të konvulsioneve dhe ECUN.</i></p> <p>Tema 14 - Të vjellat dhe regurgitimi. Refluksi gastër-intestinal tek neonati. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të shqetësimeve gastrike tek të porsalindurit.</i></p> <p>Tema 15 - Sindroma Down. Sindroma Turner. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i menaxhimit të sindromave gjenetike të diagnostikuara në periudhën neonatale.</i></p> <p>Tema 16 - Përmbledhje e patologjive kryesore neonatale. <i>Diagnostikimi klinik i diferencuar dhe plani i trajtimit të patologjive neonatale.</i></p> <p>Seminar 4 – Sindromat gjenetike. Praktikë mësimore në pavionin e Neonatologji-OBS</p>	<p>⁽¹⁾fq.94-96</p> <p>⁽¹⁾fq.97-99</p> <p>⁽¹⁾fq.405-409</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</p>
V.	<p>Kapitulli II: Rritja dhe zhvillimi</p> <p>Tema 17 - Konceptet e zhvillimit human. Zhvillimi fizik. <i>Zhvillimi fizik si rezultante e procesit të rritjes dhe pjekurisë. Matja dhe monitorimi i parametrave biometrikë.</i></p> <p>Tema 18 - Zhvillimi psikomotor. <i>Nocioni i psiko-motoricitetit si ndërveprim psikik dhe motor. Sektorët dhe ligjet e zhvillimit psikomotor.</i></p> <p>Tema 19 - Monitorimi i zhvillimit psikomotor. <i>Testi depistues Age&Stage Questionnaires. Ekzaminimet neuromotore sipas grup-moshave.</i></p> <p>Tema 20 - Zhvillimi psikologjik. <i>Teoria e Frojd-it dhe Piazhë-së.</i></p> <p>Seminar 5 - Monitorimi i zhvillimit psikomotor. Praktikë mësimore në Shërbimin Pediatric Parësor.</p>	<p>⁽¹⁾fq.104-112</p> <p>⁽¹⁾fq.113-119</p> <p>⁽¹⁾fq.120-133</p> <p>⁽¹⁾fq.134-136</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
VI.	<p>Tema 21 - Trashëgimia dhe mjedisi. Atashimi. <i>Koncepti dhe komponentet e Temperamentit të fëmijës. Fazat dhe tipat e atashimit.</i></p> <p>Tema 22 - Adoleshenca dhe puberteti. <i>Zhvillimi fizik dhe personaliteti gjatë pubertetit. Teoria e Erikson-it.</i></p> <p>Tema 23 - Fëmija i shëndetshëm. <i>Ekzaminimi klinik: procesi i observimit të fëmijës, marrja e anamnezës dhe ekzaminimi fizik.</i></p> <p>Tema 24 - Plani i ndjekjes së fëmijës normal. <i>Vizitat. Fletorja e shëndetit. Vaksinimet.</i></p> <p>Seminar 6 - Plani i ndjekjes së fëmijës normal.</p> <p>Praktikë mësimore në Shërbimin Pediatric Parësor.</p>	<p>⁽¹⁾fq.137-142</p> <p>⁽¹⁾fq.149-152</p> <p>⁽¹⁾fq.153-156</p> <p>⁽¹⁾fq.157-159</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p> <p>Praktikë 5 orë</p>
VII.	<p>Tema 25/26 - Ushqyerja natyrale <i>Laktacioni. Përparësitë e ushqyerjes me gjë. Shtesat ushqimore. Kodi i Marketingut për Zëvendësuesit e Gjirit.</i></p> <p>Tema 27 - Ablaktacioni. <i>Fillimi i ushqimeve të tjera veç qumështit të gjirit. Rreziqet e ablaktacionit të parakohshëm. Ushqyerja gjatë vitit I-II të jetës.</i></p> <p>Tema 28 - Malnutricioni proteino-kalorik. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Malnutricionit. Failure to thrive.</i></p> <p>Seminar 7 - Ushqyerja natyrale</p> <p>Praktikë mësimore në Shërbimin Pediatric Parësor.</p>	<p>⁽¹⁾fq.160-180</p> <p>⁽¹⁾fq.181-188</p> <p>⁽¹⁾fq.189-193</p>	<p>Leksion 2 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p> <p>Praktikë 5 orë</p>
VIII.	<p>Tema 29 - Abuzimi dhe neglizhenca. Konventa për të drejtat e fëmijës. <i>Parimi bazë i kësaj Konvente është se interesi më i mirë i fëmijës është në qendër të vëmendjes.</i></p> <p>Tema 30 - Përmbledhje e çështjeve kryesore të monitorimit të mirërritjes dhe mirëzhvillimit të fëmijës.</p> <p>Kapitulli III: Patologjitë pediatrike</p> <p>Tema 31 - Patologjitë e rrugëve të sipërme respiratore. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të patologjive të traktit të sipër respirator.</i></p> <p>Tema 32 - Bronkioliti. Asthma bronkiale <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Bronkiolitit dhe Asthmës bronkiale.</i></p> <p>Seminar 8 - Abuzimi dhe neglizhenca.</p> <p>Praktikë mësimore në Shërbimin Pediatric Parësor.</p>	<p>⁽¹⁾fq.198-203</p> <p>⁽¹⁾fq.205-212</p> <p>⁽¹⁾fq.213-219</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p> <p>Praktikë 5 orë</p>
IX.	<p>Tema 33 - Pneumonitë. Fibroza kistike. Bronhektazia. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Pneumonive, Mukoviscidozës dhe Bronhektazisë.</i></p> <p>Tema 34 - Vaksinimi. Difteria. <i>Llojet, kalendari dhe përdorimi i vaksinave. Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Difterisë.</i></p> <p>Tema 35 - Tetanozi. Pertusi.</p>	<p>⁽¹⁾fq.219-231</p> <p>⁽¹⁾fq.232-239</p> <p>⁽¹⁾fq.240-244</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Tetanozit dhe Pertusit.</i></p> <p>Tema 36 - Meningitet bakteriale. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Meningiteve dhe Meningokoksemisë.</i></p> <p>Seminar 9 - Vaksinimi. Praktikë mësimore në Shërbimin Pediatrik Dytësor.</p>	(¹)fq.245-249	Leksion 1 orë <i>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</i>
X.	<p>Tema 37 - Salmoneloza. Shigeloza. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të sëmundjeve diarreike.</i></p> <p>Tema 38 - Diarretë dhe dehidrimi. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të dehidrimit.</i></p> <p>Tema 39 - Tuberkulozi pulmonar. Skarlatina. Hemofilus Influence. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të TBC, Skarlatinës dhe llojet e infeksioneve të H.Influence.</i></p> <p>Tema 40 - Osteomieliti dhe Artriti supurativ. Botulizmi. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të sëmundjeve kockore dhe Botulizmit.</i></p> <p>Seminar 10 - Diarretë dhe dehidrimi. Praktikë mësimore në Shërbimin Pediatrik Dytësor.</p>	(¹)fq.254-257 (¹)fq.258-263 (¹)fq.250-253 /264-267 (¹)fq.268-275	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</i>
XI.	<p>Tema 41 - Sepsisi dhe Shock-u. <i>Plani i trajtimit të Sepsisit.</i></p> <p>Tema 42 - Parotiti. Variçela. Fruthi. Rubeola. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Parotitit, Variçelës, Fruthit dhe Rubeolës.</i></p> <p>Tema 43 - Poliomieliiti. Hepatitet virale. Sëmundja e pestë. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Poliomielitit, Eritemës infeksioze dhe Hepatiteve.</i></p> <p>Tema 44 - SIDA. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të SIDA-s tek fëmijët.</i></p> <p>Seminar 11 - Sepsisi dhe Shock-u. Praktikë mësimore në Shërbimin Pediatrik Dytësor.</p>	(¹)fq.276-279 (¹)fq.280-286 (¹)fq.287-293 (¹)fq.294-298	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</i>
XII.	<p>Tema 45 - Parazitozat. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Parazitozave të dehidrimit.</i></p> <p>Tema 46 - Ethja reumatizmale. Veset e fituara dhe të lindura të zemrës. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Ethes reumatizmale dhe Veseve kardiake.</i></p> <p>Tema 47 - Diabeti i sheqerit. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Diabetit dhe ketoacidozës.</i></p> <p>Tema 48 - Infeksionet e vijave urinare. Refluksi veziko-uretral. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Infeksioneve dhe Refluksit.</i></p> <p>Seminar 12 - Diabeti i sheqerit. Praktikë mësimore në Shërbimin Pediatrik Dytësor.</p>	(¹)fq.299-303 (¹)fq.304-315 (¹)fq.320-326 (¹)fq.330-333	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Seminar 1 orë Praktikë 5 orë</i>



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
XIII.	<p>Tema 49 - Sindroma nefrotike dhe Glomerulonefriti akut. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Sindromës nefrotike dhe Glomerulonefriti.</i></p> <p>Tema 50 - Anemitë. <i>Klasifikimi i anemive dhe diagnostikimi klinik e plani i trajtimit të Anemisë Ferriprive.</i></p> <p>Tema 51 - Drepanocitoza.Talasemitë. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Drepanocitozës dhe Talasemive.</i></p> <p>Tema 52 - Hemofilia. Sindroma hemorragjike. Leuçemitë. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Hemofilisë, Sindromës hemorragjike dhe Leuçemive.</i></p> <p>Seminar 13 - Anemitë. Praktikë mësimore në Shërbimin Pediatrik Dytësor.</p>	<p>⁽¹⁾<i>fq.337-341</i></p> <p>⁽¹⁾<i>fq.342-352</i></p> <p>⁽¹⁾<i>fq.353-358</i></p> <p>⁽¹⁾<i>fq.359-365</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Seminar 1 orë</i> <i>Praktikë 5 orë</i></p>
XIV.	<p>Tema 53 - Konvulsionet në fëmijëri. Paralizat cerebrale. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Konvulsioneve febrile dhe Paralizave.</i></p> <p>Tema 54 - Dermatitet atopike. Urtikaria. Angioedema. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të sëmundjeve me bazë alergjike.</i></p> <p>Tema 55 - Sëmundja e serumit. Shock-u anafilaktik. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të urgjencave anafilaktike.</i></p> <p>Tema 56 - Sindroma e vdekjes së papritur. Rakiti. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të SIDS dhe Rakitit.</i></p> <p>Seminar 14 - Konvulsionet në fëmijëri. Praktikë mësimore në Shërbimin Pediatrik Dytësor.</p>	<p>⁽¹⁾<i>fq.366-373</i></p> <p>⁽¹⁾<i>fq.374-378</i></p> <p>⁽¹⁾<i>fq.379-381</i></p> <p>⁽¹⁾<i>fq.382-386</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Seminar 1 orë</i> <i>Praktikë 5 orë</i></p>
XV.	<p>Tema 57 - Helminet tek fëmijët. Celiakia. Mbytja në ujë. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të Helmimeve dhe Celiakisë.</i></p> <p>Tema 58 - Monitorimi i fëmijës së sëmurë rëndë. <i>Trajtimi reanimator i fëmijës në koma. Glasgow Coma Scale.</i></p> <p>Tema 59 - Menaxhimi i dhimbjes në pediatri. <i>Vlerësimi klinik dhe metodat e trajtimit të dhimbjes.</i></p> <p>Tema 60 - Përmbledhje e patologjive kryesore pediatrike. <i>Diagnostikimi klinik i diferencuar dhe plani i trajtimit të patologjive pediatrike.</i></p> <p>Seminar 15 - Monitorimi i fëmijës së sëmurë rëndë. Praktikë mësimore në Shërbimin Pediatrik Dytësor.</p>	<p>⁽¹⁾<i>fq.387-392</i></p> <p>⁽¹⁾<i>fq.393-394</i></p> <p>⁽¹⁾<i>fq.395-397</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Seminar 1 orë</i> <i>Praktikë 5 orë</i></p>

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI:	<p>Kyçi i një edukimi të suksesshëm është pjesëmarrja dhe përgatitja. Kërkohe një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit).</p> <p>Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të</p>
---------------------	--



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

		kundërt studenti humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.				
KONTROLLI I VAZHDESHËM	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provimi final	Fundi i semestrit	Kapitulli I, II, III	90 pikë	Provimi me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Java 14/15	Rastet klinike	10 pikë	Prezantim me gojë	Raportim rasti / Demonstrim procedure
	*Detyra e kursit - Do të jetë në formën e një projekti që do të nisë në fillim të semestrit. Studentët do të përshkruajnë rastet më të shpeshta të patologjive pediatrike apo neonatale, që hasin në praktikë, duke i krahasuar me përshkrimet teorike të patologjive. Gjithashtu do të realizojnë dhe 3 plane kujdesi, bazuar në një format të gatshëm, për asistencën shëndetsore të hasur në praktikë. Një pjesë e punimeve do të prezantohen dhe në PPT.					
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare do të jetë si më poshtë:					
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
5	6	7	8	9	10	

LITERATURA	
Literatura bazë e detyruar	(1) 'Pediatria' A.Saliaj, 2017 (Fakulteti i Shëndetit Publik - UV) ISBN: 978-99956-95-89-7
Literatura e rekomanduar	<ol style="list-style-type: none"> 1. 'Pediatria' D.Bebeci 2002 (Fakulteti i Mjekësisë - UT) 2. 'E përdorim apo e keqpërdorim teknologjinë' E.Tushe 2008 (UT) 3. 'Pediatria infermiere' H.Jazo, 2005 4. 'Textbook of Paediatric' Nelson, 2008 5. 'Maternity and Pediatric Nursing' Thompson 2010

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS	
Dispozita:	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregojnë interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto prirshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjatë procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
Vonesat	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Sjellja profesionale e studentit	<p>Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijancë nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.</p>
Integriteti akademik dhe e drejta e autorit	<p>Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale, dhe në pamundësi të referojnë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzjerjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.</p>
Karakteristikat e detyrave të kursit	<p style="text-align: center;">RAPORTIMI I RASTIT</p> <p><i>Gjeneralitetet</i> – emri, mbiemri, moshë, venbanimi <i>Epidemiologjia</i> (përhapja) e sëmundjes – ku haset me shpesh: në ç’vend dhe në ç’periudhë të vitit. <i>Etiologjia</i> (shkaktarët) e sëmundjes – cili ka qenë shkaku i sëmundjes së pacientit që po raportohet. Veç kësaj do të përmenden edhe shkaktarët e tjerë të kësaj sëmundjeje sipas literaturës. <i>Klinika</i> e sëmundjes:</p> <ul style="list-style-type: none">○ Gjithë paraqitja klinike e sëmundjes në momentin e raportimit○ Ecuria klinike që nga momenti i fillimit të sëmundjes (anamnezis morbi) Gjatë paraqitjes klinike të sëmundjes do të evidentohen tiparet klinike karakteristike të sëmundjes që paraqet pacienti, së bashku me shenja të tjera klinike që nuk janë tipike apo nuk janë pjesë e kësaj sëmundjeje.○ Paraqiten gjithë problemet e tjera shëndetsore apo të stilit të jetesës që ka pacienti, si dhe mënyrat e mundshme sesi ato mund të kenë ndikuar në klinikën apo trajtimin e sëmundjes bazë (anamnesis vitae)○ Pas kësaj, duke iu referuar literaturës, do të paraqitet spektri i plotë i tipareve klinike dhe komplikacioneve të sëmundjes në fjalë. <p><i>Diagnostikimi:</i></p> <ul style="list-style-type: none">▪ Do të paraqitet diagnoza klinike e vendosur nga mjeku përkatës dhe do të argumentohen arsyet pse është vendosur kjo diagnozë.▪ Do të renditen ekzaminimet që ka kryer pacienti dhe do të referohen nga literatura të gjitha ekzaminimet e mundshme, duke nënvizuar ekzaminimin kyç në vendosjen e diagnozës së kësaj sëmundjeje. <p><i>Trajtimi:</i></p> <ul style="list-style-type: none">▪ Do të paraqitet ecuria e trajtimit që nga fillimi i sëmundjes, çfarë është ndryshuar në këtë plan trajtimi apo plan asistence dhe pse.▪ Do të paraqitet trajtimi aktual i të sëmurit, duke argumentuar arsyet pse është vendosur në këtë plan asistence në momentin aktual të zhvillimit të sëmundjes.▪ Do të referohen nga literatura planet e tjera të mundshme të asistencës së të sëmurit. Do të krahasohen ato me planin aktual të asistencës të pacientit.▪ Do të jepen rekomandimet e mundshme për përmirësimin e planit aktual të asistencës së pacientit. <p><i>Prognoza</i> (parashikimi mbi ecurinë e sëmundjes):</p> <ul style="list-style-type: none">○ Do të referohet prognoza e pacientit sipas mjekut që e ndjek.○ Do të bëhet një parashikim sipas mendimit personal të referuesit. <p>Rregullat për paraqitjen e detyrave / projekteve të kursit:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Të gjitha punimet duhet të dorëzohen në kohën e caktuar. Ato duhet të tregojnë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

që në paraqitje një stil profesionist.

- Duhet të jenë të shtypura. Punet me shkrim dore nuk do të pranohen dhe studenti do të vlerësohet automatikisht me 0 pikë.
- Në punime gjuha duhet të jetë zyrtare, letrare dhe neutrale. Ndalohen rreptësisht përdorimet e zhargoneve të pa argumentuara, shprehjet që rëndojnë etikën profesionale dhe njerëzore, kërcënimet, fyerjet, sharjet, etiketimet, tendencat politizuese, trajtimet jashtë tematikave të kërkuara, etj.
- Punët duhet të kenë një volum me më tepër se 3 faqe (format A⁴, shkrimi Times New Roman, 12 pt) dhe në faqet e para duhet të jenë të shënuara pa gabime drejtshkrimore:

Emri i Studentit
Titulli i punimit
Kursi dhe grupi përkatës i studentit
Data e dorëzimit të punimit sipas grafikut të shpallur
Emri i instruktorit
Numri i faqeve

Elementët e vlerësimit të detyrës së kursit do të përfshijnë:

Thelbësore:

- Respektimin e strukture së punimit shkencor
- Renditjen e argumenteve akademiko-shkencorë
- Mënyrat specifike të trajtimit të çështjeve në raport me realitetin shqiptar

Ndihmëse:

- Ideja e zgjedhur
- Mënyra e organizimit të punimit
- Logjika e përdorimit të koncepteve
- Përputhja me objektivat e programit mësimor
- Argumentet dhe analiza kritike